



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1538 prot.

Tiranë, më 09. 11. 2020

**V E N D I M**

**Nr. 160, datë 09. 11. 2020**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 83, datë 22.07.2020, e shtetasit M. Ç., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (në vijim DPP) dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë (në vijim DVP Vlorë), në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të përkatësisë prindërore, gjendjes familjare dhe çdo shkak tjetër.*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas palës ankuese, pas shpalljes së datës së konkurimit për në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë në Tiranë, ka përgatitur dokumentacionin në përputhje me Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Rregulloren e Policisë e miratuar me VKM-në Nr. 750, datë 16.09.2015, duke i paraqitur ato në kohën dhe vendin e përcaktuar. Pas këtyre veprimeve, në muajin shtator 2019 ka marrë pjesë në dy testimet, atë teorik dhe më pas atë fizik duke u shpallur fitues.

Në muajin tetor 2019, është paraqitur pranë DVP Vlorë për të zhvilluar intervistën e besueshmërisë. Ka qëndruar në pritje për të marrë përgjigjen përfundimtare lidhur me pranimin ose jo në Kolegjin e Policisë. Rreth datës 25.10.2019, është paraqitur në DVP Vlorë për të marrë një informacion për datën e fillimit të kursit dhe aty është informuar në rrugë verbale për mospranimin e tij në Kolegjin e Policisë. Në këto kushte, ka kërkuar informacion dhe shpjegime rreth mosprimit, por nuk ka marrë asnjë informacion veç atij në rrugë verbale.

Përsa më sipër, më datë 26.10.2019, i është drejtuar në rrugë zyrtare Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke kërkuar informacion lidhur me arsyet e mosprimit të tij në Kolegjin e

Policisë. Më datë 04.11.2019, me anë të shkresës nr. 686/1-M nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPP, është informuar ndër të tjera se: *“...Jeni skualifikuar nga vazhdimi i studimeve në Kolegjin e Policisë, në Akademinë e Sigurisë, nga Komisioni i Pranimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për mosplotësim të kriterëve ligjore, parashikuar nga neni 38, pika 2, shkronja f të ligjit nr. 108/2014 ‘Për Policinë e Shtetit’, i ndryshuar dhe nenin 139 të Rregullores së Policisë së Shtetit, të miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015, mbi bazën e dokumentacionit të ardhur nga strukturat kompetente për verifikimin e besueshmërisë”*.

Bashkëngjitur përgjigjes së sipërcituar, ankuesit i është vënë në dispozicion një kopje e Vendimit Nr. 82, datë 21.10.2019 *“Për mospranimin në Kolegjin Profesional të Lartë ‘Kolegji i Policisë’ të M. Ç.”*, në të cilin ndër të tjera sqarohet se: *“...Komisioni i Pranimit, i mbledhur sot në datën 21.10.2019, mori në shqyrtim dokumentacionin e ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë. Pas verifikimit të relacionit nr. 2545/7, date 07.10.2019 të DVP Vlorë dhe vërtetimit të besueshmërisë bashkëlidhur relacionit, rezultoi se kandidati nuk plotëson kriteret ligjore t’u pranuar në Kolegjin Profesional të Lartë ‘Kolegji i Policisë’, në Akademinë e Sigurisë...”*.

Në këto kushte, në datën 07.11.2019 ankuesi i është drejtuar me ankesë Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave (në vijim SHÇBA) në Ministrinë e Brendshme. Në përgjigje të ankesës së bërë, SHÇBA me anë të shkresës nr. 2624/1, datë 05.12.2019, i ka kthyer të njëjtën përgjigje si më sipër, duke e informuar ndër të tjera se rezultoi kandidaturë e papërshtatshme për tu pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Përsa më lart, ankuesi i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Në kërkesë padinë e ngritur, ankuesi ka kundërshtuar aktin administrativ, vendimin nr. 82, datë 21.09.2019, duke kërkuar njëkohësisht detyrimin e palës së paditur që të bënte edhe pranimin e tij në Kolegjin e Policisë, duke rivendosur në këtë mënyrë në vend të drejtat e mohuara sipas tij.

Gjatë shqyrtimit<sup>1</sup> të mosmarrëveshjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në seancë përgatitore, përfaqësuesja e palës së paditur, në prapësimet e saj nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar besueshmërinë e M. Ç., por përpara gjykatës është shprehur se: *“...babai i paditësit dyshohet se ka qënë i implikuar në veprimtari kriminale”*.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, pas shqyrtimit të mosmarrëveshjes, me vendimin nr. 98, datë 10.02.2020, vendosi pranimin e plotë të kërkesë padisë. Duke mos rënë

---

<sup>1</sup> Referuar paragrafit 3, faqja 13 e Vendimit Nr. 98, datë 10.02.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

dakord me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, DPP dhe DVP Vlorë kanë ankimuar atë në Gjykatën Administrative të Apelit, çështje e cila është ende në proces shqyrtimi.

Nisur nga veprimet dhe përgjigjet e kthyer nga ana e institucioneve e sipërcituara, ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, i është drejtuar DVP Vlorë, me anë të një kërkesë, nëpërmjet së cilës ka kërkuar të dhëna për babain e tij L. Ç., gjatë kohës që pati shërbyer në Policinë e Shtetit dhe nëse arkivat e tyre kishin të dhëna të tilla të cilat mund të kenë ndikuar në vërtetimin e besueshmërisë, i cili u bë ‘pengesë’, duke e skualifikuar nga Kolegji i Policisë.

Nëpërmjet shkresës nr. 230/1 prot., datë 11.06.2020, DVP Vlorë, ndër të tjera ka informuar ankuesin se: *“...L. Ç. ka qënë punonjës i Policisë së Shtetit për periudhën prej 25.09.1992 deri në datën 15.05.2000, datë në të cilën është nxjerrë në lirim me motivacionin ‘Braktisje detyre’. Të dhëna të tjera të cilat ju i kërkon nga dosja personale nuk i disponojmë pasi në bazë të procedurave standarde për administrimin, përditësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të personelit në Kartotekën e Policisë së Shtetit’, dosja ruhet për një periudhë 10 vjeçare në Kartotekën e Personelit dhe me plotësimin e këtij afati dërgohen në Arkivën e Ministrisë së Brendshme.”*

Përsa më sipër, pala ankuese pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, duke u privuar nga e drejta për t’u pranuar në Kolegjin e Policisë, për shkak të dyshimit se babai i tij mund të jetë përfshirë në veprimtari kriminale.

Në përfundim ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Konstatimin e diskriminimit;
- Marrjen e informacionit lidhur me klasifikimin e tij si të papërshtatshëm për t’u arsimuar në Kolegjin e Policisë;
- Rikthimin e së drejtes për t’u pranuar në Kolegjin e Policisë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 83, datë 22.07.2020, të shtetasit M. Ç. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1072/1 prot., datë 30.07.2020 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues DPP-së dhe DVP-së Vlorë, lidhur me pretendimet e ankuesit, sa më poshtë vijon:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Informacion lidhur me arsyet për të cilat ankuesi nuk është kualifikuar për të vijuar studimet në Kolegjin e Policisë.
- Kopje të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit të Pranimit, për skualifikimin e ankuesit.
- Kopje të dokumentit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e besueshmërisë së M. Ç., ku cilësohen arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë.
- Informacion dhe dokumentacion shoqëruar me anë të të cilit të provohen arsyet e skualifikimit të M. Ç. nga konkurimi për në Kolegjin e Policisë.

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Informacion lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore (si dhe kopje të tyre), në të cilat është e parashikuar procedura që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë për kandidatët për punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit.

Në përgjigje përsa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me anë të shkresës nr. 381/1-M prot., datë 17.08.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...M. Ç., ka qënë pjesëmarrës në konkurrimin për pranim në Kolegjin e Lartë Profesional, “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë, në vitin 2019. Ai ka kaluar me sukses testet teorike dhe praktike por është skualifikuar nga vazhdimi i studimeve për mosplotësim të kriterit ligjor, parashikuar në nenin 38, pika 2, shkronja “f” të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar...Bazuar në dispozitat e sipërcituara, strukturat kompetente të hetimit të krimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë kanë kryer procedurat e verifikimit, nga ku ka rezultuar se shtetasi M. Ç. nuk është i përshtatshëm për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit. Mbi këtë bazë, Komisioni i Pranimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me vendimin nr. 82, datë 21.10.2019, ka vendosur mospranimin e shtetasit M. Ç. në Kolegjin e Lartë Profesional, “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë.”*

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë nga informacionet e kërkuara në shkresën nr. 1072/1 prot., datë 30.07.2020.

2. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, Komisioneri me anë të shkresës nr. 1173/1 prot., datë 21.09.2020, kërkoi sërish plotësimin e informacionit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, lidhur me ankesën e M. Ç., sa më poshtë vijon:

- Kopje të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit të Pranimit, për skualifikimin e ankuesit.
- Kopje të dokumentit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e besueshmërisë së M. Ç., ku cilësohen arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijim e studimeve në Akademinë e Sigurisë.
- Informacion dhe dokumentacion shoqërues me anë të të cilit të provohen arsyet e skualifikimit të M. Ç. nga konkurimi për në Kolegjin e Policisë.
- Informacion lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore (si dhe kopje të tyre), në të cilat është e parashikuar procedura që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë për kandidatët për punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me anë të shkresës nr. 13909/2 prot., datë 29.09.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Sikur ju*

ka informuar edhe Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, me shkresë nr. 3551/1, datë 24.08.2020, në bazë të pikës 1, të nenit 139 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, aplikanti që kalon me sukses procesin e testimi i nënshtrohet verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale. Mbas verifikimeve të kryera nga strukturat e hetimit të krimeve, Komisariati i Policisë Vlorë, ne shkresën nr. 6373/1, date 30.09.2019, ka konfirmuar se shtetasi M. L. Ç., lindur më 22.05.1988, nuk mund të pajiset me “Vërtetim besueshmërie” pasi ndaj babit të tij L. G. Ç. gjenden të dhëna që e implikojnë në veprimtari kriminale. Mbi këtë bazë, Komisioni i Pranimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me vendimin nr. 82, datë 21.10.2019, ka vendosur mospranimin e shtetasit M. Ç. në Kolegjin e Lartë Profesional, “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë.”

Në lidhje me kërkesat e KMD-së, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, sqaroi se: “...Lidhur me kërkesën e pikës 1 dhe 2, sqarojmë se dokumenti “Vërtetimi i besueshmërisë” për shtetasin M. Ç. dhe materialet shoqëruese që kanë shërbyer gjatë verifikimit të të dhënave të këtij shtetasi, administrohen nga strukturat përkatëse në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, të cilat nuk mund të jepen pasi bazuar në pikën 11, të Urdhrit nr. 417, datë 02.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për formën dhe përmbajtjen e vërtetimit të besueshmërisë” dhe në pikën 197, të Urdhrit nr. 527, datë 24.09.2019, të Ministrit të Brendshëm “Për listen e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në Ministrinë e Brendshme dhe në strukturat në varësi të saj”, janë të klasifikuara “Sekret shtetëror”. Lidhur me kërkesën tuaj të pikës 3, me të cilën kërkon informacion mbi arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë, është sqaruar hollësisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, me shkresat nr. 381/1, date 17.08.2020 dhe nr. 3551/1, date 24.08.2020, të dërguara në institucionin tuaj.

Në lidhje me kërkesën e pikës 4, ju bëjmë me dije se procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë, janë të përcaktuara në nenin 38, ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, si dhe në kreun II të Rregullores së Policisë së Shtetit të miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015.

Në lidhje me kërkesën e pikës 5, sqarojmë se strukturat e Policisë së Shtetit, që kanë për detyrë përzgjedhjen e kandidatëve për në Akademinë e Sigurisë, nuk kanë shpjegime apo të dhëna të tjera përveç sa shpjeguar në këtë shkresë.”

3. Me shkresën nr. 1072/2 prot., datë 21.09.2020, KMD iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së cilës i kërkoi informacion lidhur me faktin nëse L. G. Ç., lindur në Mifol, Vlorë, në datën 01.02.1958 dhe banues në Vlorë, është gjykuar nga dhoma penale e Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Vlorë, në vitet 2000 - 2019. Nëse po, u kërkua që ky informacion të dërgohet në adresë të Komisionerit.

- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën<sup>3</sup> Nr. 1370 prot., datë 12.10.2020, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi i kryer në indekset penale që disponon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk rezulton që për shtetasin L. G. Ç., të jenë dhënë vendime penale”*.
- 4. Me shkresën nr. 1072/3 prot., datë 21.09.2020, KMD iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, së cilës i kërkoi informacion mbi gjendjen gjyqësore të L. G. Ç., lindur në Mifol, Vlorë, në datën 01.02.1958 dhe banues në Vlorë. Nëse po, u kërkua që ky informacion të dërgohet në adresë të Komisionerit.
- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën<sup>4</sup> Nr. 9448/1 prot., datë 24.09.2020, informoi Komisionerin se shtetasi L. G. Ç. rezultoi i padënuar.
- 5. Me shkresën nr. 1072/4 prot., datë 21.09.2020, KMD iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së cilës i kërkoi informacion mbi faktin nëse L. G. Ç., lindur në Mifol, Vlorë, në datën 01.02.1958 dhe banues në Vlorë, ka qënë nën hetim për vitet 2000-2019. Nëse po, u kërkua që ky informacion të dërgohet në adresë të Komisionerit.
- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën<sup>5</sup> nr. 9082 prot., datë 28.09.2020, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi i bërë në rregjistrat dhe sistemin kompjuterik në të cilin pasqyrohen të dhënat e rregjistrat të veprave penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, nuk rezultoi të ketë procedim penal, në funksion të të cilit të jetë regjistruar emri i këtij shtetasi...”*.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesit për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur sa i përket skualifikimit nga konkurimi në

---

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1408 prot., datë 25.09.2020

<sup>4</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1286 prot., datë 25.09.2020

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1380 prot., date 30.09.2020

Kolegjin e Policisë, për shkak të dyshimit se babai i tij mund të jetë përfshirë në veprimtari kriminale.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin<sup>6</sup> ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimet e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se:

Rezultoi e provuar gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, se M. Ç. ka qenë aplikant në konkurimin për pranim në Kolegjin e Lartë Profesional *“Kolegji i Policisë”*, në Akademinë e Sigurisë. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPP), rezulton se pas verifikimit mbi plotësimin e kriterëve për pranimin në Akademinë e Sigurisë, të përcaktuara në nenin 38, të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*<sup>7</sup>, të ndryshuar, ankuesi është përzgjedhur për të vazhduar fazat e konkurimit, të parashikuara në pikën 1, të nenit 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015.

Në nenin 135, të Rregullores për Policinë e Shtetit, miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, përcaktohen të gjitha fazat e konkurimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë. Neni i sipërcituar parashikon: *“1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurimit sipas rendit të mëposhtëm:*

---

<sup>6</sup> LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

<sup>7</sup> Neni 38, pikat 1 e 2 të të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” parashikojnë: *“Pranimi në Akademinë e Policisë bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur. 2. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të mos jetë i përjashtuar nga policia apo të jetë larguar nga shërbimi civil; c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën; d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm; dh) të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur; e) të mos jetë i dënues me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B.”*



- a) testimi me shkrim;
- b) testimi të aftësive fizike;
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimi të aftësive të shkruarit;
- ç) testimi psikologjik;
- d) kontrollit shëndetësor;
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit.

2. Drejtori i Policisë së Shtetit përcakton rregullat e testimi, kufirin minimal të pikëve, si dhe peshën specifike që do të ketë secili prej testeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në raport me rezultatin e përgjithshëm të aplikantit.”

Për sa më sipër, rezulton se M. Ç. ka kaluar me sukses të gjitha fazat e konkurimit për në Akademinë e Policisë, duke mbërritur në fazën e Verifikimit Përfundimtar. Në nenin 139, të Rregullores për Policinë e Shtetit miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, parashikohet shprehimisht: “1. Aplikanti që kalon me sukses procesin e testimi të përcaktuar në nenin 135, gërma “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet procesit të verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.2. Numri i aplikantëve që do t’i nënshtrohen procesit të verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është i njëjtë me kuotën për konkurim të përcaktuar në fillim të procesit. 3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës. 4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit. 5. Relacioni (lidhja 17) me dokumentacionin e çdo aplikanti fitues, i dërgohet Akademisë së Sigurisë.”

Mbështetur në parashikimin e pikës 4, të nenit të mësipërm, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë kreu verifikimet përkatëse mbi ankuesin, nëse ai apo pjesëtarë të familjes së tij janë të implikuar në veprimtari kriminale. Referuar shkresës nr. 13909/2, datë 29.09.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit rezulton se Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, pas verifikimeve të kryera nga strukturat e krimeve, Komisariati i Policisë Vlorë, ka konfirmuar se shtetasi M. L. Ç., nuk mund të pajset me “Vërtetim besueshmërie”, pasi ndaj babait të tij L. G. Ç. gjenden të dhëna që e implikojnë në veprimtari kriminale. Ky dokument nuk u vu në dispozicion në KMD-së nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me arsyetimin se ai përbën informacion të klasifikuar. Pavarësisht sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit e ka informuar KMD-në se Vërtetimi i Besueshmërisë për M. Ç. ishte negativ, pasi ishin konstatuar probleme, të cilat pengonin pranimin e tij në polici, pasi ankuesi ka pjesëtarë të familjes (babain) të implikuar në veprimtari kriminale.

Në këto kushte, pas verifikimit të relacionit nr. 2545/7, datë 07.10.2019 të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe vërtetimit të besueshmërisë, me Vendimin nr. 82, datë 21.10.2019, Komisioni i Pranimit, vendosi skualifikimin e M. Ç.

M. Ç., më datë 26.10.2019, ka depozituar ankesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ky institucion i ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 686/1-M duke e informuar ndër të tjera se është skualifikuar nga vazhdimi i studimeve për mosplotësim të kriterëve ligjore, parashikuar nga neni 38, pika 2, shkronja f të ligjit nr. 108/2014 ‘Për Policinë e Shtetit’, i ndryshuar dhe nenin 139 të Rregullores së Policisë së Shtetit, të miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015, mbi bazën e dokumentacionit të ardhur nga strukturat kompetente për verifikimin e besueshmërisë”.

Në vijim, në datën 07.11.2019, ankuesi ka depozituar ankesë edhe pranë Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), pranë Ministrisë së Brendshme. Në përgjigje të ankesës së bërë, SHÇBA me anë të shkresës nr. 2624/1, datë 05.12.2019, i ka kthyer të njëjtën përgjigje si më sipër, duke e informuar ndër të tjera se rezulton kandidaturë e papërshtatshme për tu pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Përsa më lart, ankuesi i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje. Gjatë shqyrtimit<sup>8</sup> të mosmarrëveshjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në seancë përgatitore, përfaqësuesja e palës së paditur, në prapësimet e saj nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar besueshmërinë e M. Ç., por përpara gjykatës është shprehur se: “...babai i paditësit dyshohet se ka qënë i implikuar në veprimtari kriminale”.

Në arsyetimin<sup>9</sup> e bërë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, në vendimin nr. 98, datë 10.02.2020, citon sa më poshtë vijon: “...privimi i paditësit për t’u arsimuar në degën që ka zgjedhur, konkuruar dhe fituar, është bërë në kundërshtim me ligjin dhe të drejtat themelore të tij. Paditësi si shtetas i Republikës së Shqipërisë ka të drejtën Kushtetuese të arsimohet e të fitojë një profesion për të cilin ka zgjedhur...Gjykata çmon se paditësi M. Ç. i plotëson të gjitha kriteret, kriteret këto të pasqyruara në nenin 38 të ligjit nr. 108/2014 (të ndryshuar), si dhe në VKM nr. 750, datë 16.09.2015. Rezulton e provuar se babai i paditësit quhet L. Ç. dhe për një periudhë rreth 10 vjeçare ka shërbyer si punonjës policie i nivelit zbatues dhe është larguar nga policia në vitet 2000-2001. Nga pala e paditur nuk u paraqit ndonjë provë që të vërtetojë

---

<sup>8</sup> Referuar paragrafit 3, faqja 13 e Vendimit Nr. 98, datë 10.02.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

<sup>9</sup> Paragrafi 3, 4 dhe 5, faqja 13 e vendimit.

*motivacionin e largimit nga policia apo ndonjë provë që të vërtetojë se babai i paditësit të ketë qënë i implikuar në veprimtari kriminale. Vetë pala e paditur në pohimet e saj përpara gjykatës ka përdorur termin ‘dyshohet’. Në nenin 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim të formës së prerë. Edhe në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale të RSH është sanksionuar prezumimi i fajësisë, pra çdo nënshtetas shqiptar prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim të formës së prerë...”.*

Gjithashtu, në faqen 14, paragrafi 3, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, ka arsyetuar se: “...paditësi sipas të gjitha provave të deklaruara dhe të hulumtuara edhe nga pala e paditur rezulton të jetë një person korrekt, i pa implikuar në ndonjë veprimtari të ndaluar, të gjitha këto të dhëna janë grumbulluar nga agjencitë e ndryshme ligjzbatuese në vend, nga ana tjetër kriteri i vendosur në germën ‘f’ të nenin 38, të ligjit nr. 108/2014 ‘Për Policinë e Shtetit’ e thotë qartë se ky kriter është: kandidati duhet të jetë i pajisur me ‘vërtetim besueshmërie’, pra kandidati, jo ndonjë person tjetër i familjes...”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, pas shqyrtimit të mosmarrëveshjes, me vendimin nr. 98, datë 10.02.2020, vendosi pranimin e plotë të kërkesë padisë, i cili është kundërshtuar nga DPP dhe DVP Vlorë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nisur nga veprimet dhe përgjigjet e kthyer nga ana e institucioneve e sipërcituara, ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, i është drejtuar DVP Vlorë, me anë të një kërkesë, nëpërmjet së cilës ka kërkuar të dhëna për babain e tij L. Ç., gjatë kohës që pati shërbyer në Policinë e Shtetit.

Nëpërmjet shkresës nr. 230/1 prot., datë 11.06.2020, DVP Vlorë, ndër të tjera ka informuar ankuesin se nuk i disponojnë pasi përditësimi dhe ruajtja e dokumentacionit të personelit bëhet në Kartotekën e Policisë së Shtetit.

Përgjatë hetimit administrativ, në referencë të korrespondencës zyrtare që KMD pati me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Zyrën e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezultoi se L. G. Ç., babai i ankuesit rezultonte i pa hetuar dhe i pa dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 30, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet shprehimisht: “*Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë*”.

Në këtë kontekst, L. G. Ç. konsiderohet i pafajshëm, për sa kohë në ngarkim të tij nuk është dhënë nga gjykata kompetente asnjë vendim penal i formës së prerë.

Referuar doktrinës juridiko-penale, termi *“veprimtari kriminale”* përkufizohet në kuptimin e tij të ngushtë dhe në kuptimin e tij të gjerë. Në kuptim të ngushtë, veprimtaria kriminale nënkupton kryerjen e një ose disa krimeve ose veprave penale. Në kuptimin e gjerë ose atë kriminologjik dhe sociologjik, ky term nënkupton kryerjen e disa veprave penale, në mënyrë të organizuar, të paramenduar dhe të planifikuar në fusha të ndryshme, të tilla si fushën e trafikimit të narkotikëve, qënieve njerëzore, vjedhjes etj. Referuar interpretimit në kuptim të ngushtë apo edhe të gjerë të termit të mësipërm, L. G. Ç., babai i ankuesit, në asnjë rast nuk mund të akuzohet apo të pretendohet se është i implikuar në veprimtari kriminale.

Për sa më sipër, L. G. Ç., nuk rezulton gjithashtu se bën pjesë apo është i implikuar në veprimtarinë e organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura, dhe as në grupe të strukturuar kriminale, në kuptim të nenit 28 të Kodit Penal. Ai nuk ka qenë dhe nuk është i dënuar penalisht nga organet gjyqësore.

Komisioneri gjykon se nga të dhënat e administruara, rezulton se L. G. Ç., në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se është marrë apo ka qenë i implikuar në aktivitet kriminal.

Përdorimi i arsytimit se L. G. Ç., ka qenë i implikuar në aktivitet kriminal, kur ai nuk është dënuar apo hetuar për asnjë vepër penale, si dhe nuk ekziston asnjë provë konkrete ligjore për të provuar një fakt të tillë, krijon dyshimin e arsyeshëm se skualifikimi i ankuesit është bërë pa asnjë shkak të justifikuar.

Në këto kushte, Komisioneri krijon bindjen, në interpretim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, se Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave e kanë ekspozuar ankuesin M. Ç. ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën e subjektit ankues, pretendohet diskriminim, për shkak të *për shkak të të përkatësisë prindërore, gjendjes familjare dhe çdo shkak tjetër*, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

Përkatësia prindërore dhe gjendja familjare, janë shkaqe, për të cilët, Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën,*

*ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të përkatësisë prindërore, Komisioneri vlerëson se përkatësia prindërore është shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si të tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, për të vërtetuar atë. Në bazë të dokumentacionit të depozituar në cilësi prove rezulton se ankuesi M. L. Ç. është djali i L. G. Ç.

Përsa i përket pretendimit të diskriminimit për shkak të gjendjes familjare, ankuesi nuk vuri në dispozicion të Komisionerit, prova dhe fakte, që të justifikojë këtë shkak. Duke vlerësuar se përkatësia prindërore është ajo çfarë ankuesi ka dashur të shpreh nëpërmjet gjendjes familjare, Komisioneri nuk e sheh të nevojshëm shqyrtimin e këtij shkak.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

Ankuesi pretendon diskriminim për shkak të "*përkatësisë prindërore*", nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë vendore të Policisë Vlorë.

Legjislacioni ndërkombëtar dhe ai shqiptar ofron mbrojtje të posaçme nga diskriminimi për shkak të përkatësisë prindërore.

Neni 1<sup>10</sup>, i Protokollit 12, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara më ligj, si dhe afirmon ndalimin e diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të nenit të kësaj konvente, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së, nëse nga sjellja (veprimi ose mosveprimi) i autoriteteve shtetërore, i mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njej individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik.

---

<sup>10</sup> Neni 1, protokollit 12 i KEDNJ parashikon shprehimisht: “1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

Neni 14 i KEDNJ-së parashikon shprehimisht: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër<sup>11</sup>”

Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996) që ndalon diskriminimin për një liste joshteruese shkaqesh. Neni E, në Pjesën V të kësaj Karte parashikon shprehimisht: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër<sup>12</sup>”.

Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”

*Përkatësia prindërore* është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 17, pika 2, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimit në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: “*“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

<sup>11</sup> “Përkatësia prindërore” është shkak që bën pjesë nën opsionin “çdo status tjetër”;

<sup>12</sup> “Përkatësia prindërore” është shkak që bën pjesë nën opsionin “çdo status tjetër”;

Mbështetur në pikën 2, të të njëjtit nen përcaktohet shprehimisht: *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Kodi i Procedurës Administrative<sup>13</sup>, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast subjekteve kundër së cilëve drejtohet ankesa, të cilët duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, pika 10 të tij ka parashikuar se: *“Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS<sup>14</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka

---

<sup>13</sup> Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

<sup>14</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>15</sup>

Mbështetur në provat e administruara gjatë hetimit administrativ të çështjes rezultoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e subjekteve kundër së cilave drejtohet ankesa. M. Ç. është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pas Vërtetimit Negativ të Besueshmërisë, të hartuar nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Sipas këtij vërtetimi, babai i ankuesit është i implikuar në veprimtari kriminale, për të cilën nuk u administrua asnjë provë nga organet kompetente. Gjatë analizimit të fakteve dhe provave, rezultoi se babai i ankuesit, nuk rezulton të ketë qenë nën hetim nga organi i prokurorisë, nuk ka qenë i gjykuar ndonjëherë për veprën penale të vrasjes nga gjykata kompetente, si dhe referuar gjendjes së tij, gjyqësore, ai rezulton i padënuar.

Për sa më sipër, mbështetur në provat e administruara nga KMD, nuk rezultoi se Vlerësimi i Besueshmërisë, së bërë nga personat përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë të ishte i mbështetur në prova dhe fakte konkrete. Në këtë kuptim, Komisioneri ngre dyshimet e arsyeshme se vlerësimi i tyre është bërë duke përdorur informacione nga burime të jashtme, të cilat kanë rezultuar të pambështetura në fakte dhe prova konkrete.

Në pikën 4, të nenit 139, të Rregullores për Policinë e Shtetit miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, parashikohet shprehimisht: “.....4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.” Procedurat e miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit për kryerjen e këtyre verifikimeve nuk janë bërë asnjëherë të ditura, fakt që dëshmon për mungesë transparence. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se punonjësit e policisë kanë diskrecion të gjerë në përcaktimin dhe hartimin e Vërtetimit të Besueshmërisë së individit, që konkurron në Akademinë e Sigurisë. Njëkohësisht mos ekzistenca e transparencës dhe diskrecioni i gjerë

<sup>15</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.



ngrenë shqetësime, lidhur me parashikimin e nenit 139 të Rregullores së Policisë së Shtetit, që afekton individët vetëm për shkak se një i afërm i tyre, mund të jetë përfshirë në aktivitet kriminal. Komisioneri gjykon se mohimi i një të drejte nuk mund të vijë si pasojë e mos transparencës, diskrecionit të pakufizuar dhe përgjegjësisë së të tretëve.

Vërtetimi i Besueshmërisë është hartuar nga personat përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se përgjegjësia bie mbi institucionin e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

Pavarësisht se ankuesi ka depozituar disa herë ankesa pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave, pranë Ministrisë së Brendshme, këto institucione e kanë konsideruar të drejtë Vërtetimin e Besueshmërisë, pavarësisht fakteve të mësipërme, që kanë qenë mëse të qarta.

Në analizë fakteve të mësipërme, Komisioneri gjykon se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga subjektet përkatëse kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek këta subjekte.

Komisioneri vlerësoi se nga ana e këtyre subjekteve nuk u arrit të provohej që veprimet e tyre kundrejt ankuesit kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale. Në këtë kontekst, është mëse evidente se skualifikimi i M. Ç. ka ndodhur pasi është supozuar se babai i tij ka qenë i implikuar në aktivitet kriminal, edhe pse një gjë e tillë ka qenë totalisht e pambështetur në fakte dhe prova të besueshme.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi thekson se, është i kuptueshëm fakti që nga ana e subjekteve të administratës publike apo edhe private, të mos vendoset në dispozicion të procedurave të shqyrtimit administrativ, informacion që prek të dhëna konfidenciale apo sensitive subjekteve. Por, mos vënia në dispozicion e akteve nënligjore, si në rastin konkret, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me argumentin se janë informacione të klasifikuara "*Sekret*"<sup>16</sup>, nuk mund të justifikohet me arsyetimin se përhapja e tyre shkakton dëme serioze të sigurisë kombëtare. Kjo, për faktin se Urdhërat e kërkuar nga ana e Komisionerit, sa i përket procedurës që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë, janë akte publike për të cilat minimalisht organet ligjzbatuese të administratës publike, duhet të kenë të drejtën për t'i administruar.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se M. Ç., është diskriminuar për shkak të përkatësisë prindërore.

---

<sup>16</sup> Referuar përcaktimit të parashikuar në nenin 3, pika b) e ligjit Nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për Informacionin e Klasifikuar "Sekret Shtetëror", të ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenit 17, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të M. Ç., për shkak të përkatësisë prindërore, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që M. Ç. të ndjekë studimet pranë Akademisë së Sigurisë në vitin akademik 2020 - 2021.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankimi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Përkatësia prindërore)

(Fusha: Arsim)